Global Resource Trading Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:


| | FAQE |
|---|---|
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 2 |
| PASQYRA E PERFORMANCËS | 3 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 4 |
| PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE | 5 |
| SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE | 6 - 16 |

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**
**më 31 dhjetor 2015**

| | Shënime | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|---|
| **Aktive afatshkurtra** | | | |
| Mjete monetare | 4 | 705,037 | - |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 5 | 59,768,966 | - |
| Të tjera llogari të arketueshme | 6 | 75,874 | - |
| Parapagime dhe Shpenzime të shtyra | 7 | 534,584 | - |
| **Total Aktive Afatshkurtra** | | **61,084,461** | - |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 8 | 399,100 | |
| **Total aktive afatgjata** | | **399,100** | - |
| **Total Aktive** | | **61,483561** | - |
| DETYRIMET | | | |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | |
| Hua afatshkurtra nga palët e lidhura | 9 | 17,846,400 | - |
| Llogari të pagueshme tregtare | 10 | 25,967,645 | - |
| Te tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 11 | 248,951 | - |
| Detyrime tatimore | 12 | 2,679,824 | - |
| Të tjera detyrime | 13 | 181,084 | - |
| **Total Detyrime afatshkurtra** | | **46,923,904** | - |
| **Detyrime afatgjata** | | | |
| **Total Detyrime afatgjata** | | - | - |
| **Totali i detyrimeve** | | **46,923,904** | - |
| **Kapitali** | | | |
| Kapitali i nënshkruar | | 100,000 | - |
| Fitimi i ushtrimit | | 14,459,657 | - |
| **Total kapitali** | 14 | **14,559,657** | - |
| **Totali i kapitalit dhe detyrimeve** | | **61,483,561** | - |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 15 | 153,529,884 | - |
| Të ardhura të tjera të shfrytezimit | 16 | 198,651 | - |
| **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** | 17 | **(136,274,674)** | - |
| 1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | | (132,627,438) | - |
| 2) Të tjera shpenzime | 18 | (3,647,236) | - |
| **Shpenzime të personelit** | 19 | **(227,247)** | |
| 1) Paga dhe shpërblime | | (194,727) | - |
| 2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndëtsore | | (32,520) | - |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 20 | (1,733) | - |
| Shpenzime të tjera të shfrytëzimit | | (88) | - |
| **Të ardhura te tjera** | | - | - |
| **Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra** | | - | - |
| **Shpenzime financiare** | 21 | **(113,700)** | - |
| 1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | | (110,011) | - |
| 2) Shpenzime të tjera financiare | | (3,689) | - |
| **Fitimi/humbja para tatimit** | 22 | **17,111,093** | - |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | | **(2,651,435)** | |
| 1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | 23 | (2,651,435) | |
| **Fitimi/humbja e vitit** | 23 | **14,459,657** | |
| Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin: | | - | - |
| **Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin** | | - | - |
| **Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin** | | **14,459,657** | - |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

| | Kapitali i nënshkruar | Fitimi i vitit | Totali |
|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014** | - | - | - |
| Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin: | | | |
| Fitimi i vitit | | 14,459,657 | 14,459,657 |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | 100,000 | | 100,000 |
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015** | 100,000 | 14,459,657 | 14,559,657 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Global Resource Trading shpk më 25 Mars 2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Ina Topalli Szymanska
Administrator

GLOBAL RESOURCE TRADING
Rr. Ibrahim Rugova, Kulla 1, Kati 6, Ap 24
NIPT: L52117145V

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@ mazars.al

Mazars Shpk

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|---|
| **Flukset e parasë nga aktivitetet operative** | | | |
| Fitim / Humbja e vitit | | 14,459,657 | - |
| Rregullimet për shpenzimet jomonetare: | | | |
| Shpenzimet financiare jomonetare | | 35,039 | - |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | | 1,733 | - |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | | (60,379,424) | - |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | | 28,592,847 | - |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | | **(17,290,148)** | - |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare nga /(përdorur në) aktivitetin e investimit** | | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | | (400,833) | - |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | | **(400,833)** | - |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare nga /(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | | |
| Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar | | 100,000 | - |
| Hua të arkëtuara | | 18,091,662 | - |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | **18,191,662** | - |
| **Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare** | | **500,681** | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar | | - | - |
| *Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare* | | 204,356 | - |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor** | 4 | **705,037** | - |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

"Global Resource Trading" shpk, është një shoqëri e regjistruar më 17 shtator 2015 si shoqëri me përgjegjësi te kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me Nipt L52117145V.
Selia e shoqërisë është Rruga "Ibrahim Rugova" Kompleksi Green Park, Kulla 1 Ap, 24 Tiranë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 pjesë me vlerë nominale 1,000 LEK për një vlerë totale 100,000 LEK.

Ortakët e shoqërisë janë:

| | |
|---|---|
| Jakub Wojcien Szymanski | 51% |
| Ina Topalli Szymanska | 49% |

Administrator i shoqërisë është znj. Ina Topalli Szymanska.
Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shkëmbime tregtare, Import-Export. Tregti me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, të gjitha llojet e pijeve alkolike, pajisjeve elektronike dhe elektroshtepiake etj. Konsulencë dhe shërbime financiare.
Në 31 dhjetor 2015 shoqëria ka 2 punonjës.

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.
Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare ne përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet e pasqyrave financiare.

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.
Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 është detajuar si më poshtë:

| **Kursi i këmbimit** | **2015** |
|---|---|
| Euro/LEK | 137.28 |
| USD/ LEK | 125.79 |

### 3.2. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

## 3. Politikat Kontabël (vazhdim)
## 3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

*Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

*Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

*Kapitali themeltar*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

## 3.3 Aktive afatgjata materiale

*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit për efekt fiskal për vitin aktual janë si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve | Norma e Amortizimit |
|---|---|
| Mobilje për zyrën | 20 % |
| Pajisje për zyrën dhe informatike | 25 % |

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**
**3.3 Aktive afatgjata material (vazhdim)**

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.4. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**3.6. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

**3.7. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.
Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 eshte 15%.

**3.8. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

**3.9. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

## 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Mjete monetare në bankë | | |
| Banka ALL | 105,940 | - |
| Banka EUR | 599,097 | - |
| **Totali** | **705,037** | - |

## 5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Klientë | 59,768,966 | - |
| **Totali** | **59,768,966** | - |

## 6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Shteti- TVSh për t'u rimbursuar | 75,874 | - |
| **Totali** | **75,874** | - |

## 7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Parapagime për furnitorët | 522,047 | - |
| Shpenzime të shtyra | 12,537 | - |
| **Totali** | **534,584** | - |

*(Vlerat janë në Lek)*

## 8. Aktive Afatgjata Materiale

| | Mobilje dhe orendi | Pajisje informatike | Pajisje elektronike | Totali |
|---|---|---|---|---|
| *Kosto* | - | - | - | - |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2014** | - | - | - | - |
| Shtesa | 282,000 | 7,000 | 111,833 | 400,833 |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2015** | **282,000** | **7,000** | **111,833** | **400,833** |
| ***Amortizimi i akumuluar*** | | | | |
| Amortizimi i vitit | 1,733 | - | - | 1,733 |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2015** | **1,733** | | | **1,733** |
| *Vlera neto kontabël* | | | | |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2014** | - | - | - | - |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2015** | **280,267** | **7,000** | **111,833** | **399,100** |

## 9. Hua afatshkurtra nga palët e lidhura

Huaja afatshkurtër nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Hua afatshkurtra nga palët e lidhura | 17,846,400 | - |
| **Totali** | **17,846,400** | **-** |

## 10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Llogari të pagueshme tregtare | 25,967,645 | - |
| **Totali** | **25,967,645** | **-** |

## 11. Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 248,951 | - |
| **Totali** | **248,951** | **-** |

## 12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 detajohet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Sigurime shoqerore shëndetësore | 20,088 | - |
| Të ardhura personale punonjës (TAP) | 2,600 | - |
| Tatim Fitimi | 2,621,435 | - |
| Tatim në burim | 35,701 | - |
| **Totali** | **2,679,824** | **-** |

## 13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe te tjera detyrime më 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Paga per t'u paguar | 61,337 | - |
| Debitore & kreditorë të tjerë | 119,747 | - |
| **Totali** | **181,084** | - |

## 14. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100.000 lekë.

**Fitimi i ushtrimit**

Shuma prej 14,459,658 lekë përfaqëson fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015.

## 15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 153,529,884 | - |
| **Totali** | **153,529,884** | - |

## 16. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore | (355,447) | - |
| Fitim nga këmbimet dhe përkthimet valutore | 324,098 | - |
| Të ardhura të tjera | 230,000 | - |
| **Totali** | **198,651** | - |

## 17. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave te shituar e cila detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Blerje mallrash | 132,627,438 | - |
| **Totali** | **132,627,438** | - |

## 18. Te tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Sherbime nga të tretë | 1,755,229 | - |
| Shpenzime transpoti | 886,700 | - |
| Shpenzime qeraje | 128,000 | - |
| Komisione bankare | 466,054 | - |
| Shpenzime postare dhe telekomunikacioni | 206,190 | - |
| Shpenzime te tjera | 164,294 | - |
| Blerje te ndryshme,kancelari etj | 28,316 | - |
| Taksa te ndryshme | 12,453 | - |
| **Totali** | **3,647,236** | - |

## 19. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Shpenzime për paga | 194,727 | - |
| Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore | 32,520 | - |
| **Totali** | **227,247** | - |

## 20. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 :

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Shpenzime për interesa | (110,011) | - |
| Shpenzime nga kursi i këmbimit për hua | (3,689) | - |
| **Totali** | **(113,700)** | - |

## 21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| ***Fitimi para tatimit*** | **17,111,093** | - |
| Shpenzime të panjohura | 565,139 | - |
| ***Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)*** | **17,676,232** | - |
| ***Tatim fitimi 15%*** | 2,651,435 | - |
| **Fitimi neto** | **14,459,658** | - |

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | % |
|---|---|---|
| Fitimi i vitit para tatimit | 17,111,093 | 100% |
| Tatim fitimi me normën e aplikueshme | 2,566,664 | 15% |
| *Rregullimet për diferencat:* | | |
| Shpenzime të pazbritshme | 84,771 | 0.5% |
| **Totali** | **2,651,435** | 53% |

## 22. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|---|---|---|
| **Pozicioni financiar** | | |
| **Hua** | | |
| Hua nga palët e lidhura | 17,846,400 | - |
| **Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura** | | |
| Ina Topalli Szymanska | 248,951 | - |

## 24. Angazhime dhe pasiguri

Me 31 dhjetor 2015 kompania kishte kontrata qeraje operative në lidhje me marrjen me qera të zyrave në Tiranë. Minimumi i pagesave të ardhshme sipas kontratave janë si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|
| Brenda një viti | 64,000 | - |
| **Totali** | **64,000** | - |

## 25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.